



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 121/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve standarde të tenderit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 86748-02-11-2021, me objekt “*Kalimi i ndriçimit në LED për efijencën energjitike në terminale dhe në infrastrukturën portuale*”, me fond limit 46,074,000 lekë pa TVSH, publikuar më datë 12.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues: “Mag Utilities” shpk
Adresa: “Rezidenca Kodra e Diellit 2”, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor Autoriteti Portual Durrës
Adresa: Rruga “Tregtare”, Lagjja Nr. 1, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.02.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 86748-02-11-2021, me objekt “*Kalimi i ndriçimit në LED për efijencën energjitime në terminale dhe në infrastrukturën portuale*”, me fond limit 46,074,000 lekë pa TVSH, publikuar më datë 12.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 17.02.2021, operatori ekonomik “*Mag Utilities*” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentet si më poshtë:

I nderuar titullar i Autoritetit Kontraktor te Autoritetit Portual, Durres.

Shoqëria jonë, pasi u njoh me kërkesat për kualifikim dhe dokumentet e tenderit, të procedurës së mësipërme të prokurimit, të cilën po ankimojmë, konstatojmë se janë vendosur kritere diskriminuese, konfuze, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, nuk i vendosin ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi, ulin pjesëmarrjen e ofertuesve në tender, kufizojnë konkurrencën e lirë, si dhe janë vendosur në kundërshtim flagrant me ligjin

e prokurimit publik, për të cilën përgjegjësia bie mbi njësinë e prokurimit, si persona përgjegjës të cilët kanë hartuar dhe miratuar kërkesat për kualifikim dhe kanë hartuar specifikimet teknike, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

Sa më sipër, duke mos qenë dakord me këto kritere diskriminuese dhe të tejfryra, po ju dërgojmë për shqyrtim formularin standard të ankimit, si shkallë e parë ankimi, bazuar kjo në nenin 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin publik, i ndryshuar.

1. Lidhur me licensimet dhe kategoritë e shoqërive pjesëmarrëse, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar edhe pika e licensës NP 10 B, ku kjo pikë licensë, referuar Vendimit nr. 42, ka të bëjë me ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike.

Sipas dokumentacionit që ju keni publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, preventivit, konstatohet se nuk keni asnjë zë për prodhim energjie elektrike. Pra, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar kjo pikë licensë me qëllim që të ulët konkurrenca në prokurim, duke kërkuar licensa të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që ju po prokuroni. Si mund të kërkohet një pikë për prodhim energjie, kur ju po tenderoni për blerje malli?

Kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues, i cili ul konkurrencën në prokurim, diskriminon shoqëritë ofertuese, si dhe pengon pjesëmarrjen në tender të shoqërive që duan të marrin pjesë në tender.

2. Referuar specifikimeve teknike të publikuara nga ana juaj në sistemin e prokurimit elektronik, rezultojnë se ato janë kufizuese dhe diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim në kundërshtim me nenin 23 të LPP.

Nga ana e autoritetit tuaj kontraktor janë përcaktuar fuqia në WATT e ndriçuesve dhe elementë të tjerë, të cilat kufizojnë shoqëritë e tjera për të ofruar një ndriçues me efikasitet më të lartë se sa ju kërkoni.

Në dokumentin e specifikimeve teknike për ndriçuesit ekuivalentë ju përcaktoni vetëm fuqinë e llambës në WATT, tensionin e llambës, llojin e llambës, shkallën e mbrojtjes IP66 dhe strukturën alumin, ndërkohë në listën e materialeve ju përcaktoni shumë më tepër detaje teknike të ndriçuesve ekuivalentë si p.sh. fluksin e dritës, temperaturën e dritës, llojin e montimit, këndin e dritës, përmasat e ndriçuesit, etj., që duhet të zëvendësojnë ndriçuesit aktual.

Në këto kushte lind pyetja se ne si OE kujt dokument duhet ti referohemi për të bërë ofertën tonë më të mirë.

Në dokumentin Lista e Materialeve ju keni përcaktuar fuqinë ekzakte në WATT për çdo tip dhe fluksin e dritës në lumens që duhet të ketë çdo ndriçues dhe ky është një kriter diskriminues. Kjo pasi një shoqëri ofertuese mund të ofrojë të njëjtin fluks ndriçimi të kërkuar nga ju në LUMENS, por duke përdorur WATT më të ulta dhe teknikë tjetër sipas standardeve ndërkombëtare EU/EN e kombëtare në fuqi, gjë e cila do të rezultonte edhe në kursim energjie dhe rrjedhimisht kursim ekonomik dhe financiar për ju. Pra në rast se nuk do ti

referoheni standardeve ndërkombëtare dhe EU/EN, ju mund të përcaktoni vetëm maksimumin e fuqisë në WATT por jo minimumin, pasi kjo do të sillte dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor.

Referuar standardeve EU/EN, çdo rrugë, shesh, ambient ka një kategorizim të caktuar dhe të veçantë i cili përcakton fluksin e dritës dhe specifikimet e tjera të lidhura me ndriçimin e nevojshëm. Në rast se do ti referoheshit dhe do të na vinit në dispozicion kategorinë e vendit ku do të përdoret secili tip, ne si OE pjesëmarrës mund të bënim ofertën tonë me të mirë të bazuar në këto standarde duke rezultuar në kursim për Autoritetin Kontraktor. Por në asnjë nga dokumentet e publikuara nga ju nuk përcaktohet asnjë kategori ose specifikim teknik për vendin ku do të përdoren këta ndriçues.

Në dokumentin Lista e Materialeve keni vendosur përmasa të ndriçuesve. Ky është një kriter diskriminues pasi përcaktimi ekzakt i përmasave kufizon mundësinë e konkurrimit. P.sh. në Tipin 1 ju përcaktoni përmasat 725x570x130 mm, po nëse këto përmasa do të ishin 728x566x135 mm çfarë do të ndryshonte në ndriçimin e kërkuar? E njëjta situatë është për të gjithë tipet e ndriçuesve. Përcaktimi i përmasave ekzakte ul mundësinë e konkurrencës në mos edhe garanton paracaktimin e fituesit. Për këtë arsye kërkojmë heqjen ose modifikimin e këtij kriteri.

Në dokumentin Specifikime teknike ndriçuesin aktual Tip 1 dhe Tip 5 i keni njësoj ndërsa Ekuivalentët për Tip 1 e keni 750 WATT ndërsa ekuivalenti për Tip 5 e keni 500 WATT. E njëjta gjë ndodh me ndriçuesit TIP 2 dhe Tip 3, ku ndriçuesi aktual është për të dy këto tipe 250 WATT ndërsa ekuivalenti për Tip 2 është 100 WATT ndërsa për Tip 3 është 150 WATT.

Në këto kushte paqartësie të specifikimeve të kërkuara, paqartësi të mënyrës së nxjerrjes së këtyre specifikimeve të cilat janë të shpërndara në dokumente të ndryshme që s'përkojnë vetëm me dokumentin e specifikimeve teknike dhe specifikimesh kontradiktore ne kërkojmë të na vini në dispozicion një projekt ndriçimi dhe të na sqaroni se ku është mbështetur autoriteti juaj kontraktor, kujt standardeve në hartimin e këtyre specifikimeve teknike i jeni referuar. Dhe se si është bërë ekuivalentimi i kthimit nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar. Kjo pasi OE që do të marrin pjesë në këtë garë, duke ditur kategorizimin e kërkuar me lart nga ana jonë sipas standardeve EU/EN ose duke ditur formulën e përdorur nga ju për konvertimin nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar, i jep mundësinë çdo OE të ofrojnë produkte me efikasitet më të lartë sesa ato të kërkuara nga ju.

3. Lidhur me elektrikistët nuk e kuptojmë se sa duhet të jetë numri i tyre, pasi njëherë kërkon 5 me IQT, pastaj përcaktoni 1 me certifikatë.

Gjithashtu, na sqaroni se ku qëndron ndryshimi midis elektrikistëve me IQT me ato me certifikatë, pasi kurse trajnimi organizohen edhe nga institucione private. Në këtë mënyrë, nga ana juaj është kufizuar konkurrenca në prokurim.

4. Njësia juaj e prokurimit ka kërkuar në kundërshtim me Udhëzimet e APP edhe certifikatat ISO të prodhuesit.

5. Në kundërshtim me Udhëzimet edhe Vendimet që APP ka dhënë, keni kërkuar certifikatën CE, e cila jepet vetëm pasi një shoqëri ka blerë mallin. Nëse nga ana juaj ndodheni në këto kushte, atëherë anuloni procedurën e prokurimit.

Sa më sipër, kërkojmë modifikimin e dokumenteve të tenderit, përfshirë edhe specifikimet teknike dhe vendosjen e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ose anulimin e procedurës së prokurimit.

II.2.1. Në datën 24.02.2021 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 540/1 i kthen përgjigje palës ankimuese “Mag Utilities” shpk duke vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues konkretisht si mëposhtë vijon:

Komisioni, pasi administroi dokumentacionin e nevojshëm, shqyrtoi dhe analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti ankimues.

Në përfundim të këtij procesi, KSHA arriti në konkluzionet, që parashtrihen në vijim sipas pikave të parashtruara nga ana juaj:

1. Pretendimet e OE

Lidhur me licensimet dhe kategoritë e shoqërive pjesëmarrëse, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar dhe pika e licensës NP 10 B, ku kjo pikë license, referuar Vendimit nr. 42, ka të bëjë me ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike.

Sipas dokumentacionit që ju keni publikuar në sistemin e prokurimit elektronik preventiv, konstatohet se nuk keni asnjë zë për prodhim energjie elektrike. Pra, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar kjo pikë license me qëllim që të ulet konkurrenca në prokurim, duke kërkuar licensa të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që ju po prokuroni. Si mund të kërkohet një pikë për prodhim energjie, kur ju po tenderoni për blerje malli ?

Kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues, i cili ul konkurrencën në prokurim, diskriminon shoqëritë ofertuese, si dhe pengon pjesëmarrjen në tender të shoqërive që duan të marrin pjesë në tender.

Në lidhje me sa më sipër keni kërkuar, KSHA e vlerëson kërkesën e vendosur për licensë NP 10 B duke e konsideruar procedurën si të një rëndësie të veçantë të kalimit në sistem ndriçimi LED për reduktim të konsumit të energjisë dhe me këtë është synuar që të ofertojnë operatorë ekonomikë që njohin dhe janë të licencuar në ndërtim impiantesh e sisteme të ndriçimit. Pavarësisht kësaj KSHA duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv), vlerëson se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

Për rrjedhim të sa më sipër, duke iu përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe pikës 3, të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, KSHA vlerëson që pretendimi juaj

qëndron dhe duhet të pranohet kërkesa juaj për heqjen e këtij kriteri. Ky ndryshim do të reflektohet në Shtojcë.

2. Pretendimet e OE

Referuar specifikimeve teknike të publikuara nga ana juaj në sistemin e prokurimit elektronik, rezultojnë se ato janë kufizuese dhe diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim në kundërshtim me nenin 23 të LPP.

Nga ana e autoritetit tuaj kontraktor janë përcaktuar fuqia në WATT e ndriçuesve dhe elementë të tjerë, të cilat kufizojnë shoqëritë e tjera për të ofruar një ndriçues me efikasitet më të lartë se sa ju kërkoni.

Në dokumentin e specifikimeve teknike për ndriçuesit ekuivalentë ju përcaktoni vetëm fuqinë e llambës në WATT, tensionin e llambës, llojin e llambës, shkallën e mbrojtjes IP66 dhe strukturën alumin, ndërkohë në listën e materialeve ju përcaktoni shumë më tepër detaje teknike të ndriçuesve ekuivalentë si p.sh. fluksin e dritës, temperaturën e dritës, llojin e montimit, këndin e dritës, përmasat e ndriçuesit, etj., që duhet të zëvendësojnë ndriçuesit aktual.

Në këto kushte lind pyetje se ne si OE kujt dokumenti duhet ti referohemi për të bërë ofertën tonë më të mirë.

Në lidhje me sa më sipër keni kërkuar, KSHA sqaron se duhet ti referoheni dokumentit të ngarkuar në SPE me emërtim “Lista e materialeve”, si dokument që ka të detajuar specifikimet e mallrave të kërkuara.

3. Pretendimet e OE

Në dokumentin Lista e Materialeve ju keni përcaktuar fuqinë ekzakte në WATT për çdo tip dhe fluksin e dritës në lumens që duhet të ketë çdo ndriçues dhe ky është një kriter diskriminues. Kjo pasi, një shoqëri ofertuese mund të ofrojë të njëjtin fluks ndriçimi të kërkuar nga ju në LUMENS, por duke përdorur WATT më të ulta dhe teknikë tjetër sipas standardeve ndërkombëtare EU/EN e kombëtare në fuqi, gjë e cila do të rezultonte edhe në kursim energjie dhe rrjedhimisht kursim ekonomik dhe financiar për ju. Pra në rast se nuk do ti referoheni standardeve ndërkombëtare dhe EU/EN, ju mund të përcaktoni vetëm maksimumin e fuqisë në WATT por jo minimumin, pasi kjo do të sillte dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor.

Në lidhje me sa më sipër keni kërkuar, KSHA sqaron se duhet ti referoheni dokumentit të ngarkuar në SPE me emërtim “Lista e materialeve”, si dokument që ka të detajuar specifikimet e mallrave të kërkuara.

Në lidhje me sa keni kërkuar rishikim të specifikimeve që mos të ketë të përcaktuar fuqi ekzakte në WATT, KSHA vlerëson që pretendimi juaj qëndron dhe duhet të pranohet kërkesa juaj për rishikimin e përcaktimeve. Ky ndryshim do të reflektohet në Shtojcë.

4. Pretendimet e OE

Referuar standardeve EU/EN, çdo rrugë, shesh, ambient ka një kategorizim të caktuar dhe të veçantë i cili përcakton fluksin e dritës dhe specifikimet e tjera të lidhura me ndriçimin e nevojshëm. Në rast se do ti referoheshit dhe do të na vini në dispozicion kategorinë e vendit ku do të përdoret secili tip, ne si OE pjesëmarrës mund të bënim ofertën tonë më të mirë të bazuar në këto standarde duke rezultuar në kursim për Autoritetin Kontraktor.

Por në asnjë nga dokumentet e publikuara nga ju nuk përcaktohet asnjë kategori ose specifikim teknik për vendin ku do të përdoren këta ndriçues.

Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se vendosja e produkteve realizohet në bazë dhe për përmbushjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor dhe është ai që studion dhe përcakton dhe vendos se ku apo si do përdoren produktet. Operatori Ekonomik është i detyruar thjeshtë të sigurojë produktet e kërkuara duke përmbushur të dhënat teknike të specifikuara dhe ofruar shërbimin e vendosjes së tyre. Pra kemi të bëjmë me procedurë furnizim vendosje.

5. Pretendimet e OE

Në dokumentin “Lista e Materialeve” keni vendosur përmasa të ndriçuesve. Ky është një kriter diskriminues, pasi përcaktimi ekzakt i përmasave kufizon mundësinë e konkurrimit. p.sh. në Tipin 1 ju përcaktoni përmasat 725x570x130mm, po nëse këto përmasa do të ishin 728x566x135mm çfarë do të ndryshonte në ndriçimin e kërkuar ? E njëjta situatë është për të gjithë tipet e ndriçuesve. Përcaktimi i përmasave ekzakte ul mundësinë e konkurrencës në mos edhe garanton paracaktimin e fituesit. Për këtë arsye kërkojmë heqjen ose modifikimin e këtij kriteri.

Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron përmasat tek lista materialeve për produktet e kërkuara janë vendosur, pasi duhet siguruar njëfarë uniformiteti bazuar dhe sipas projektit paraprak.

6. Pretendimet OE

Në dokumentin Specifikimet teknike ndriçuesin aktual Tip 1 dhe Tip 5 i keni njësoj ndërsa Ekuivalentët për Tip 1 e keni 750 ËATT ndërsa ekuivalenti për Tip 5 e keni 500 WATT. E njëjta gjë ndodh me ndriçuesit Tip 2 dhe Tip 3, ku ndriçuesi aktual është për të dy këto tipe 250 WATT, ndërsa ekuivalenti për Tip 2 është 100 WATT ndërsa për Tip 3 është 150 WATT.

Në këto kushte paqartësie të specifikimeve të kërkuara, paqartësi të mënyrës së nxjerrjes së këtyre specifikimeve të cilat janë të shpërndara në dokumente të ndryshme që nuk përkojnë vetëm me dokumentin e specifikimeve teknike dhe specifikimesh kontradiktore, ne kërkojmë të na vini në dispozicion një projekt ndriçimi dhe të na sqaroni se ku është mbështetur autoriteti juaj kontraktor, kujt standardeve në hartimin e këtyre specifikimeve teknike i jeni referuar. Dhe se si është bërë ekuivalentimi i kthimit nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar. Kjo pasi OE që do të marrin pjesë në këtë garë, duke ditur kategorizimin e kërkuar më lart nga ana jonë

sipas standardeve EU/EN ose duke ditur formulën e përdorur nga ju për konvertimin nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar, i jep mundësinë çdo OE të ofrojë produkte me efikasitet më të lartë sesa ato të kërkuara nga ju.

Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se vendosja e produkteve realizohet në bazë dhe për përmbushjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor dhe është ai që studion dhe përcakton dhe vendos se ku apo si do përdorën produktet.

Operatori Ekonomik është i detyruar thjeshtë të sigurojë produktet e kërkuara duke përmbushur të dhënat teknike të specifikuara dhe ofruar shërbimin e vendosjes së tyre, duke ju referuar ndryshimeve që do të pësoje dokumenti ngarkuar në SPE me emërtim “Lista e materialeve”, si dokument që ka të detajuar specifikimet e mallrave të kërkuara. Pra kemi të bëjmë me procedurë furnizim vendosje.

7. Pretendimet e OE

Lidhur me elektrikistët nuk e kuptojmë se sa duhet të jetë numri i tyre, pasi njëherë kërkonte 5 me IQT, pastaj përcaktoni 1 me certifikatë. Gjithashtu, na sqaroni se ku qëndron ndryshimi midis elektrikistëve me IQT me ato me certifikatë, pasi kurse trajnimi organizohen edhe nga institucione private. Në këtë mënyrë, nga ana juaj është kufizuar konkurrenca në prokurim.

Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se për sa i përket pretendimeve tuaja komisioni sqaron se numri total i elektrikistëve duhet të jetë 5 (të gjithë të pajisur me Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga IQT) ku minimumi 1 nga ata të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla e mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky parashikim është vendosur që punonjësi i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional do jetë dhe person përgjegjës për punën e stafit në furnizim - vendosjen e mallrave të kërkuara dhe nuk kemi të bëjmë me kufizim konkurrence.

8. Pretendimet e OE

Njësia juaj e prokurimit ka kërkuar në kundërshtim me Udhëzimet e APP edhe certifikatat ISO të prodhuesit.

Në kundërshtim me Udhëzimet dhe Vendimet që APP ka dhënë, keni kërkuar certifikatën CE, e cila jepet vetëm pasi një shoqëri ka blerë mallin. Në lidhje mesa keni kërkuar, KSHA vlerëson se pretendimi juaj nuk qëndron, mallrat që do ofertoni duhet të shoqërohen me certifikatat e kërkuara dhe sqarojmë që këto certifikata shoqërojnë mallin jo vetëm në blerje por dhe para blerjes së tyre në marrjen e ofertës tek prodhuesi nga ana juaj.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga shoqëria “Mag Utilities” shpk, për të cilat strukturat e Autoritetit Kontraktor do i reflektojnë në Shtojcë.

II.2.2. Në datën 24.02.2021, operatori ekonomik “Mag Utilities” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.3. Me shkresën me nr. 780 prot, datë 08.03.2021, protokolluar me tonën me nr. 342/2 prot, datë 09.03.2021, me objekt “Informacion” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” shpk se: *“Lidhur me licensimet dhe kategoritë e shoqërive pjesëmarrëse, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar edhe pika e licensës NP 10 B, ku kjo pikë license, referuar Vendimit nr. 42, ka të bëjë me ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike. Sipas dokumentacionit që ju keni publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, preventivit, konstatohet se nuk keni asnjë zë për prodhim energjie elektrike. Pra, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar kjo pikë license me qëllim që të ulet konkurrenca në prokurim, duke kërkuar licensa të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që ju po prokuroni. Si mund të kërkohej një pikë për prodhim energjie, kur ju po tenderoni për blerje malli ? Kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues, i cili ul konkurrencën në prokurim, diskriminon shoqëritë ofertuese, si dhe pengon pjesëmarrjen në tender të shoqërive që duan të marrin pjesë në tender.”*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 9/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

2. Licensa Profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontratave

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- a) N.P.10 - B Ndërtime të impianteve per prodhimin e energjise elektrike.

- b) *N.P.11 – A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e Tensionit të Lartë T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.*
- c) *N.S.5 - A Ndërtime për Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.*
- d) *N.S.14-A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.*

- *Në plotësim të kësaj kërkesë, Ofertuesi duhet të paraqesë kopje të noterizuar të Certifikatës së licensimit,*

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008).

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kerkohet Licensa Profesionale.

III.1.2. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes “Mag Utilities” sh.p.k, me shkresën nr 540/1 prot, datë 24.02.2021, ka cituar si më poshtë vijon:

Lidhur me licensimet dhe kategoritë e shoqërive pjesëmarrëse, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar dhe pika e licensës NP 10 B, ku kjo pikë license, referuar Vendimit nr. 42, ka të bëjë me ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike.

Sipas dokumentacionit që ju keni publikuar në sistemin e prokurimit elektronik të preventivit, konstatohet se nuk keni asnjë zë për prodhim energjie elektrike. Pra, nga ana e njësisë tuaj të prokurimit është kërkuar kjo pikë license me qëllim që të ulët konkurrenca në prokurim, duke kërkuar licensa të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin që ju po prokuroni. Si mund të kërkohet një pikë për prodhim energjie, kur ju po tenderoni për blerje malli ?

Kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues, i cili ul konkurrencën në prokurim, diskriminon shoqëritë ofertuese, si dhe pengon pjesëmarrjen në tender të shoqërive që duan të marrin pjesë në tender.

Në lidhje me sa më sipër keni kërkuar, KSHA e vlerëson kërkesën e vendosur për licensë NP 10 B duke e konsideruar procedurën si të një rëndësie të veçantë të kalimit në sistem ndriçimi LED për reduktim të konsumit të energjisë dhe me këtë është synuar që të ofertojnë operatorë ekonomikë që njohin dhe janë të licensuar në ndërtim impiantesh e sisteme të ndriçimit. Pavarësisht kesaj KSHA duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv), vlerëson se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

Për rrjedhim të sa më sipër, duke ju përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe pikës 3, të nenit 27, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, KSHA vlerëson që pretendimi juaj qëndron dhe duhet të pranohet kërkesa juaj për heqjen e këtij kriteri. Ky ndryshim do të reflektohet në Shtojcë.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, përcaktimi i kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, si edhe përcaktimi i specifikimeve teknike, duhet të jetë i saktë, i qartë, dhe jo i ekzagjeruar në mënyrë që edhe operatori ekonomik të bazohet në të dhëna të sakta gjatë hartimit të ofertës së tij.

Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, nisur edhe nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, sqaron se, autoriteti kontraktor, në kushtet kur këtë kërkesë e ka pranuar, duhet të bëjë modifikimet e nevojshme në momentin e publikimit të shtojcës në sistemin e prokurimeve elektronike, duke mos lënë asnjë mospërputhje ose keqkuptim për operatorët ekonomikë të interesuar gjatë hartimit të ofertës së tyre, si edhe për komisionin e vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke hequr kriterin në lidhje mbi disponueshmërinë e licencës NP 10 B, duke qenë se në asnjë prej zërave të parashikuar në preventiv nga autoriteti kontraktor pjesë e dokumenteve standarde të tenderit nuk parashikohet kryerja e punimeve që lidhen drejtpërdrejtë me disponueshmërinë e kësaj license.

III.1.4. Në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimes, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar këtë pretendim duke u shprehur ndër të tjera se “KSHA vlerëson që pretendimi juaj qëndron dhe duhet të pranohet kërkesa juaj për heqjen e këtij kriteri. Ky ndryshim do të reflektohet në Shtojcë”.

Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për aq sa është pranuar nga autoriteti kontraktor, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimmarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej tij. Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të

jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”, Autoriteti kontraktor është shprehur në lidhje me kërkimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues me anë të shkresës nr. 540/1 prot., datë 24.02.2021, lidhur me heqjen e kriterit të vecantë të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “[...]KSHA vlerëson që pretendimi juaj qëndron dhe duhet të pranohet kërkesa juaj për heqjen e këtij kriteri. Ky ndryshim do të reflektohet në Shtojcë”. [...], por në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së, autoriteti kontraktor nuk e ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë shtojcën, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” shpk se: “Lidhur me elektrikistët nuk e kuptojmë se sa duhet të jetë numri i tyre, pasi njëherë kërkoni 5 me IQT, pastaj përcaktoni 1 me certifikate. Gjithashtu, na sqaroni se ku qëndron ndryshimi midis elektrikistëve me IQT me ato me certifikatë, pasi kurse trajnimi organizohen edhe nga institucione private. Në këtë mënyrë, nga ana juaj është kufizuar konkurrenca në prokurim.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 9/2, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Gusht 2020 – Janar 2021 të ketë jo më pak se 27 (njëzet) punonjës në muaj, ndër të cilët:

- 2 (dy) Inxhinierë Elektrike

- 5 (pesë) Elektricitistë të certifikuar me dëshmi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT

Minimumi 1 (një) punonjës elektrikist të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla e mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi)

Për të provuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhën Gusht 2020 – Janar 2021.*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Gusht 2020 – Janar 2021.*

III.2.2. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues “*Mag Utilities*” sh.p.k, ka cituar si më poshtë vijon:

Lidhur me elektrikistët nuk e kuptojmë se sa duhet të jetë numri i tyre, pasi njëherë kërkoni 5 me IQT, pastaj percaktoni 1 me certifikatë. Gjithashtu, na sqaroni se ku qëndron ndryshimi midis elektrikistëve me IQT me ato me certifikatë, pasi kurse trajnimi organizohen edhe nga institucione private. Në këtë mënyrë, nga ana juaj është kufizuar konkurrenca në prokurim.

Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se për sa i përket pretendimeve tuaja komisioni sqaron se numri total i elektrikistëve duhet të jetë 5 (të gjithë të pajisur me Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga IQT) ku minimumi 1 nga ata të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla e mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky parashikim është vendosur që punonjësi i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional do jetë dhe person përgjegjës për punën e stafit në furnizim - vendosjen e mallrave të kërkuara dhe nuk kemi të bëjmë me kufizim konkurrencë.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, përcaktimi i kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, si edhe përcaktimi i specifikimeve teknike, duhet të jetë i saktë, i qartë, dhe jo i ekzagjeruar në mënyrë që edhe operatori ekonomik të bazohet në të dhëna të sakta gjatë hartimit të ofertës së tij.

Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, nisur edhe nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, sqaron se, autoriteti kontraktor, në kushtet kur këtë kërkesë e ka pranuar, duhet të bëjë modifikimet e nevojshme në momentin e publikimit të shtojcës në sistemin e prokurimeve elektronike, duke mos lënë asnjë mospërputhje ose keqkuptim për operatorët ekonomikë të interesuar gjatë hartimit të ofertës së tyre, si edhe për komisionin e vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të sqarojë operatorin ekonomik në lidhje me kriterin e mësipërm

duke e përcaktuar atë sa më saktë, në mënyrë që ky kriter të jetë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik.

III.2.4. Në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë këtij pretendimi të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik në kthim përgjigje në lidhje me pretendimin e tij duke u shprehur se *“Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se përsa i përket pretendimeve tuaja, komisioni sqaron se numri total i elektrikistëve duhet të jetë 5 (të gjithë të pajisur me Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga IQT) ku minimumi 1 nga ata të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla e mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky parashikim është vendosur që punonjësi i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional do jetë dhe person përgjegjës për punën e stafit në furnizim - vendosjen e mallrave të kërkuara dhe nuk kemi të bëjmë me kufizim konkurrence”*.

Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e këtij kriteri. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor në lidhje me paqartësinë e ngritur nga operatori ekonomik dhe nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për aq sa është pranuar nga autoriteti kontraktor, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej tij. Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”*, ka dhënë sqarimet për operatorin ekonomik ankimues me anë të shkresës nr. 540/1 prot., datë 24.02.2021, lidhur me kriterin e vecantë të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, *“[...]Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se përsa i përket pretendimeve tuaja komisioni sqaron se*

numri total i elektrikistëve duhet të jetë 5 (të gjithë të pajisur me Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga IQT) ku minimumi 1 nga ata të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla e mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky parashikim është vendosur që punonjësi i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë përkatëse të kualifikimit profesional do jetë dhe person përgjegjës për punën e stafit në furnizim - vendosjen e mallrave të kërkuara dhe nuk kemi të bëjmë me kufizim konkurrence [...], por këtë sqarim në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së, autoriteti kontraktor nuk e ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë këtë sqarim, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mag Utilities” mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në lidhje me kërkesën se “[...]Referuar specifitimeve teknike të publikuara nga ana juaj në sistemin e prokurimit elektronik, rezultojnë se ato janë kufizuese dhe diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim në kundërshtim me nenin 23 të LPP. Nga ana e autoritetit tuaj kontraktor janë përcaktuar fuqia në WATT e ndriçuesve dhe elementë të tjerë, të cilat kufizojnë shoqëritë e tjera për të ofruar një ndriçues me efikasitet me të lartë se sa ju kërkon. Në dokumentin e specifitimeve teknike për ndriçuesit ekuivalentë ju përcaktoni vetëm fuqinë e llambës në WATT, tensionin e llambës, llojin e llambës, shkallën e mbrojtjes IP66 dhe strukturën alumin, ndërkohë në listën e materialeve ju përcaktoni shumë më tepër detaje teknike të ndriçuesve ekuivalentë si p.sh. fluksin e dritës, temperaturën e dritës, llojin e montimit, këndin e dritës, përmasat e ndriçuesit, etj, që duhet të zëvendësojnë ndriçuesit aktual. Në këto kushte lind pyetja se ne si OE kujt dokument duhet ti referohemi për të bërë ofertën tonë më të mirë. Në dokumentin Lista e Materialeve ju keni përcaktuar fuqinë ekzakte në watt për çdo tip dhe fluksin e dritës në lumens që duhet të ketë çdo ndriçues dhe ky është një kriter diskriminues. Kjo pasi një shoqëri ofertuese mund të ofrojë të njëjtin fluks ndriçimi të kërkuar nga ju në LUMENS, por duke përdorur WATT më të ulta dhe teknikë tjetër sipas standardeve ndërkombëtare EU/EN e kombëtare në fuqi, gjë e cila do të rezultonte edhe në kursim energjie dhe rrjedhimisht kursim ekonomik dhe financiar për ju. Pra në rast se nuk do ti referoheni standardeve ndërkombëtare dhe EU/EN, ju mund të përcaktoni vetëm maksimumin e fuqisë në WATT por jo minimumin, pasi kjo do të sillte dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor. Referuar standardeve EU/EN, çdo rrugë, shesh, ambient ka një kategorizim të caktuar dhe të veçantë i cili përcakton fluksin e dritës dhe specififikimet e tjera të lidhura me ndriçimin e nevojshëm. Në rast se do ti referoheshit dhe do të na vinit në dispozicion kategorinë e vendit ku do të përdoret secili tip, ne si OE pjesëmarrës mund të bënim ofertën tonë më të mirë të bazuar në këto standarde duke rezultuar në kursim për Autoritetin Kontraktor. Por në asnjë nga dokumentet e publikuara nga ju nuk përcaktohet asnjë kategori ose specifikim teknik për vendin ku do të përdoren këta ndriçues. Në dokumentin Lista e Materialeve keni vendosur përmasa të ndriçuesve. Ky është një kriter diskriminues pasi përcaktimi ekzakt i përmasave kufizon mundësinë e konkurrimit. P.Sh. në Tipin 1 ju përcaktoni përmasat 725x570x130 mm, po nëse këto përmasa do të ishin 728x566x135 mm çfarë do të ndryshonte në ndriçimin e kërkuar ? E njëjta situatë është për

të gjithë tipet e ndriçuesve. Përcaktimi i përmasave ekzakte ul mundësinë e konkurrencës në mos edhe garanton paracaktimin e fituesit. Për këtë arsye kërkojmë heqjen ose modifikimin e këtij kriteri.

Në dokumentin Specifikime teknike ndriçuesin aktual Tip 1 dhe Tip 5 i keni njësoj ndërsa Ekuivalentët për Tip 1 e keni 750 Watt ndërsa ekuivalenti për Tip 5 e keni 500 Watt. E njëjta gjë ndodh me ndriçuesit TIP 2 dhe Tip 3, ku ndriçuesi aktual është për të dy këto tipe 250 Watt ndërsa ekuivalenti për Tip 2 është 100 Watt ndërsa për Tip 3 është 150 Watt. Në këto kushte paqartësie të specifikimeve të kërkuara, paqartësi të mënyrës së nxjerrjes së këtyre specifikimeve të cilat janë të shpërndara në dokumente të ndryshme që s'përkojnë vetëm me dokumentin e specifikimeve teknike dhe specifikimesh kontradiktore, ne kërkojmë të na vini në dispozicion një projekt ndriçimi dhe të na sqaroni se ku është mbështetur autoriteti juaj kontraktor, kujt standardeve në hartimin e këtyre specifikimeve teknike i jeni referuar. Dhe se si është bërë ekuivalentimi i kthimit nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar. Kjo pasi OE që do të marrin pjesë në këtë garë, duke ditur kategorizimin e kërkuar me lart nga ana jonë sipas standardeve EU/EN ose duke ditur formulën e përdorur nga ju për konvertimin nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar, i jep mundësinë çdo OE të ofrojnë produkte me efikasitet më të lartë sesa ato të kërkuara nga ju. [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në sistemin e prokurimeve elektronikë autoriteti kontraktor ka ngarkuar dokumentacionin me emërtimin Specifikimet teknike”, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Më poshtë janë të renditura modelet aktuale egzistuese si dhe ekuivalentët e tyre me modelet LED:

Ndriçues Tipi 1

Fuqia = 1000w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës me shkarkim (SAP)

Lloji i bazamentit të llambës E40

Mbrojtja IP65

Struktura Alumin + Metal

Problematik me oksidimin e strukturës nga lagështira dhe kripa në ajër, vështirësi në gjetjen e pjesëve të zëvendësimit.

Ndriçues Tipi 1 (ekuivalent)

Fuqia = 750w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës LED

Mbrojtja IP66

Struktura Alumin

Strukture solide dhe mundësi orientimi të drejtimit të dritës, kundra ndryshkjes dhe oksidimit.

Ndriçues Tipi 2

Fuqia = 250w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës me shkarkim (SAP)

Lloji i bazamentit të llambës E40

Mbrojtja IP65

Struktura Alumin + Polikarbonat + Plastike

Problematike amortizimi i strukturës me kalimin e kohës, vështirësi në zëvendësim.

Ndriçues Tip 2 (ekuivalent)

Fuqia = 100w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës LED

Mbrojtja IP66

Struktura Alumin

Strukturë Alumini dhe shumë e lehtë në zëvendësim, gjithashtu ka përhapje drite më të gjerë .

Ndriçues Tipi 3

Fuqia = 250w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës me shkarkim (SAP)

Lloji i bazamentit të llambës E40

Mbrojtja IP65

Struktura Alumin + Llamarine

Problematik me reflektorin dhe lëkundjet e llambave si pasojë e erës së fortë.

Ndriçues Tipi 3 (ekuivalent)

Fuqia = 150w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës LED

Mbrojtja IP66

Struktura Alumin

Strukture solide dhe përhapje drite më të gjerë, kundra ndryshkjes dhe oksidimit.

Ndriçues Tipi 4

Fuqia = 25w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës me shkarkim (SAP)

Lloji i bazamentit të llambës E40

Mbrojtja IP65

Struktura Alumin + Metal

Problematik me oksidimin e strukturës nga lagështira dhe kripa në ajër.

Ndriçues Tipi 4 (ekuivalent)

Fuqia = 100w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës LED

Mbrojtja IP66

Struktura Alumin

Strukture solide dhe mundësi orientimi të drejtimit të dritës, kundra ndryshkjes dhe oksidimit.

Ndriçues Tipi 5

Fuqia = 1000w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës me shkarkim (SAP)

Lloji i bazamentit të llambës E40

Mbrojtja IP65

Struktura Alumin + Metal

Problematik me oksidimin e strukturës nga lagështira dhe kripa në ajër, vështirësi në gjetjen e pjesëve të zëvendësimit.

Ndriçues Tipi 5 (ekuivalent)

Fuqia = 500w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës LED

Mbrojtja IP66

Struktura Alumin

Strukture solide dhe mundësi orientimi të drejtimit të dritës, kundra ndryshkjes dhe oksidimit.

Ndriçues Tipi 6

Fuqia = 600w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës me shkarkim (SAP)

Lloji i bazamentit të llambës E40

Mbrojtja IP65

Struktura Alumin + Metal

Problematik me oksidimin e strukturës nga lagështira dhe kripa në ajër, vështirësi në gjetjen e pjesëve të zëvendësimit.

Ndriçues Tipi 6 (ekuivalent)

Fuqia = 250w

Tensioni = 220v

Lloji i llambës LED

Mbrojtja IP66

Struktura Alumin

Strukture solide dhe mundësi orientimi të drejtimit të dritës, kundra ndryshkjes dhe oksidimit.

III.3.2. Në shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku Lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

LISTA E MATERIALEVE "F.V Ndricules LED"						
Nr	Pershkrimi	Te Dhenat Teknike	Njesi	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Ndricules Floodlight Tipi 1	Fuqia : 750W Tensioni I Hyrjes : 100-240V Frekuenca : 50-60Hz Cos Ø : > 0,95 Ra : ≥80 Kendi I Drites : 30-60° Ngjyra e Drites : 2700K-6500K Fluksi i Drites : 112500Lm Lumen/Watt :150 Lm/W Permasat : 725x570x130mm Temp. Ambientit : -40...+50° C Materiali :Alumin Ngjyra : E Zeze ,Nr i Ndezje/ Fikje :100000 Ore Pune : 50000 ,Grada e Mbrojtjes :IP65 Klasa e Mbrojtjes IK :IK08 Standartet : CE , Lloji i Montimit : Siperfaqesor i Levizshem : Po	cope	274		
2	Ndricules Streetlight Tipi 2	Fuqia : 100W Tensioni I Hyrjes : 100-240V Frekuenca : 50-60Hz Cos Ø : > 0,95 Ra : ≥80 Kendi I Drites : 100-120° Ngjyra e Drites : 2700K-6500K Fluksi i Drites : 15000Lm Lumen/Watt :150 Lm/W Permasat : 627x271x103,2mm Temp. Ambientit : -40...+50° C Materiali :Alumin Ngjyra : Gri Nr i Ndezje/ Fikje :100000 Ore Pune : 50000 Grada e Mbrojtjes :IP65 Klasa e Mbrojtjes IK :IK08 Standartet : CE Lloji i Montimit : Siperfaqesor I Levizshem : Jo	cope	5		
3	Ndricules Streetlight Tipi 3	Fuqia : 150W Tensioni I Hyrjes : 100-240V Frekuenca : 50-60Hz Cos Ø : > 0,95 Ra : ≥80 Kendi I Drites : 60-140° Ngjyra e Drites : 2700K-6500K Fluksi i Drites : 22500Lm Lumen/Watt :150 Lm/W Permasat : Dia 400*180mm Temp. Ambientit : -40...+50° C Materiali :Alumin Ngjyra : E Zeze Nr i Ndezje/ Fikje :100000 Ore Pune : 50000 Grada e Mbrojtjes :IP65 Klasa e Mbrojtjes IK :IK08 Standartet : CE Lloji i Montimit : Siperfaqesor I Levizshem : Jo	cope	56		
4	Ndricules Streetlight Tipi 4	Fuqia : 100W Tensioni I Hyrjes : 100-240V Frekuenca : 50-60Hz Cos Ø : > 0,95 Ra : ≥80 Kendi I Drites : 100-120° Ngjyra e Drites : 2700K-6500K Fluksi i Drites : 15000Lm Lumen/Watt :150 Lm/W Permasat : 627x271x103,2mm Temp. Ambientit : -40...+50° C Materiali :Alumin Ngjyra : Gri Nr i Ndezje/ Fikje :100000 Ore Pune : 50000 Grada e Mbrojtjes :IP65 Klasa e Mbrojtjes IK :IK08 Standartet : CE Lloji i Montimit : Siperfaqesor I Levizshem : Jo	cope	37		
5	Ndricules Floodlight Tipi 5	Fuqia : 500W Tensioni I Hyrjes : 100-240V Frekuenca : 50-60Hz Cos Ø : > 0,95 Ra : ≥80 Kendi I Drites : 30-60° Ngjyra e Drites : 2700K-6500K Fluksi i Drites : 75000Lm Lumen/Watt :150 Lm/W Permasat : 570x360x130mm Temp. Ambientit : -40...+50° C Materiali :Alumin Ngjyra : E Zeze Nr i Ndezje/ Fikje :100000 Ore Pune : 50000 Grada e Mbrojtjes :IP65 Klasa e Mbrojtjes IK :IK08 Standartet : CE Lloji i Montimit : Siperfaqesor I Levizshem : Po	cope	26		

6	Ndrives Floodlight Tipi 6	Fuqia : 250W	Tensioni I Hyrjes : 100-240V	cope	64
		Frekuenca : 50-60Hz	Cos Ø : > 0,95		
		Ra : ≥80	Kendi I Drites : 30-60°		
		Ngjyra e Drites : 2700K-6500K	Fluksi i Drites : 37500Lm		
		Lumen/Watt : 150 Lm/W	Permasat : 455x290x130mm		
		Temp. Ambientit : -40...+50°C	Materiali : Alumin		
		Ngjyra : E Zeze	Nr i Ndezje/ Fikje : 100000		
		Ore Pute : 50000	Grada e Mbrojtjes : IP65		
		Klasa e Mbrojtjes IK : IK08	Standartet : CE		
		Lloji i Montimit : Siperfaqesor	I Levizhem : Po		

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se referuar kthim përgjigjes Nr. 540/1 prot datë 24.02.2021 të autoritetit kontraktor konkretisht citohet:

Referuar specifikimeve teknike të publikuara nga ana juaj në sistemin e prokurimit elektronik, rezultojnë se ato janë kufizuese dhe diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim në kundërshtim me nenin 23 të LPP.

Nga ana e autoritetit tuaj kontraktor janë përcaktuar fuqia në WATT e ndriçuesve dhe elementë të tjerë, të cilat kufizojnë shoqëritë e tjera për të ofruar një ndriçues me efikasitet më të lartë se sa ju kërkoni. Në dokumentin e specifikimeve teknike për ndriçuesit ekuivalentë ju përcaktoni vetëm fuqinë e llambës në WATT, tensionin e llambës, llojin e llambës, shkallën e mbrojtjes IP66 dhe strukturën alumin, ndërkohë në listën e materialeve ju përcaktoni shumë më tepër detaje teknike të ndriçuesve ekuivalentë si p.sh. fluksin e dritës, temperaturën e dritës, llojin e montimit, këndin e dritës, përmasat e ndriçuesit, etj., që duhet të zëvendësojnë ndriçuesit aktual. Në këto kushte lind pyetja se ne si OE kujt dokumenti duhet ti referohemi për të bërë ofertën tonë më të mirë. Në lidhje me sa më sipër keni kërkuar, KSHA sqaron se duhet ti referoheni dokumentit të ngarkuar në SPE me emërtim “Lista e materialeve”, si dokument që ka të detajuar specifikimet e mallrave të kërkuara.

Në dokumentin Lista e Materialeve ju keni përcaktuar fuqinë ekzakte në WATT për çdo tip dhe fluksin e dritës në lumens që duhet të ketë çdo ndriçues dhe ky është një kriter diskriminues. Kjo pasi, një shoqëri ofertuese mund të ofrojë të njëjtin fluks ndriçimi të kërkuar nga ju në LUMENS, por duke përdorur WATT me të ulta dhe teknikë tjetër sipas standardeve ndërkombëtare EU/EN e kombëtare në fuqi, gjë e cila do të rezultonte edhe në kursim energjie dhe rrjedhimisht kursim ekonomik dhe financiar për ju. Pra në rast se nuk do ti referoheni standardeve ndërkombëtare dhe EU/EN, ju mund të përcaktoni vetëm maksimumin e fuqisë në WATT por jo minimumin, pasi kjo do të sillte dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor. Në lidhje me sa më sipër keni kërkuar, KSHA sqaron se duhet ti referoheni dokumentit të ngarkuar në SPE me emërtim “Lista e materialeve”, si dokument që ka të detajuar specifikimet e mallrave të kërkuara. Në lidhje me sa keni kërkuar rishikim të specifikimeve që mos të ketë të përcaktuar fuqi ekzakte në WATT, KSHA vlerëson që pretendimi juaj qëndron dhe duhet të pranohet kërkesa juaj për rishikimin e përcaktimeve. Ky ndryshim do të reflektohet në Shtojcë.

Referuar standardeve EU/EN, çdo rrugë, shesh, ambient ka një kategorizim të caktuar dhe të veçantë i cili përcakton fluksin e dritës dhe specifikimet e tjera të lidhura me ndriçimin e nevojshëm. Në rast se do ti referoheshit dhe do të na vinit në dispozicion kategorinë e vendit ku do të përdoret secili tip, ne si OE pjesëmarrës mund të bënim ofertën tonë më të mirë të bazuar në këto standarde duke rezultuar në kursim për Autoritetin Kontraktor. Por në asnjë nga dokumentet e publikuara nga ju nuk përcaktohet asnjë kategori ose specifikim teknik për vendin ku do të përdoren këta ndriçues. Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se vendosja e produkteve realizohet në bazë dhe për përmbushjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor dhe është ai që studion dhe përcakton dhe vendos se ku apo si do përdoren produktet. Operatori Ekonomik është i detyruar thjeshtë të sigurojë produktet e kërkuara duke përmbushur të dhënat teknike të specifikuara dhe ofruar shërbimin e vendosjes së tyre. Prandaj kemi të bëjmë me procedurë furnizim vendosje.

Në dokumentin “Lista e Materialeve” keni vendosur përmasa të ndriçuesve. Ky është një kriter diskriminues, pasi përcaktimi ekzakt i përmasave kufizon mundësinë e konkurrimit. p.sh. në Tipin 1 ju përcaktoni përmasat 725x570x130mm, po nëse këto përmasa do të ishin 728x566x135mm çfarë do të ndryshonte në ndriçimin e kërkuar? E njëjta situatë është për të gjithë tipet e ndriçuesve. Përcaktimi i përmasave ekzakte ul mundësinë e konkurrencës në mos edhe garanton paracaktimin e fituesit. Për këtë arsye kërkojmë heqjen ose modifikimin e këtij kriteri. Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron përmasat tek lista materialeve për produktet e kërkuara janë vendosur pasi duhet siguruar njëfarë uniformiteti bazuar dhe sipas projektit paraprak.

Në dokumentin Specifikimet teknike ndriçuesin aktual Tip 1 dhe Tip 5 i keni njësoj ndërsa Ekuivalentët për Tip 1 e keni 750 WATT ndërsa ekuivalenti për Tip 5 e keni 500 WATT. E njëjta gjë ndodh me ndriçuesit Tip 2 dhe Tip 3, ku ndriçuesi aktual është për të dy këto tipe 250 WATT, ndërsa ekuivalenti për Tip 2 është 100 WATT ndërsa për Tip 3 është 150 WATT.

Në këto kushte paqartësie të specifikimeve të kërkuara, paqartësi të mënyrës së nxjerrjes së këtyre specifikimeve të cilat janë të shpërndara në dokumente të ndryshme që nuk përkojnë vetëm me dokumentin e specifikimeve teknike dhe specifikimesh kontradiktore ne kërkojmë të na vini në dispozicion një projekt ndriçimi dhe të na sqaroni se ku është mbështetur autoriteti juaj kontraktor, kujt standardeve në hartimin e këtyre specifikimeve teknike i jeni referuar. Dhe se si është bërë ekuivalentimi i kthimit nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar. Kjo pasi OE që do të marrin pjesë në këtë garë, duke ditur kategorizimin e kërkuar më lart nga ana jonë sipas standardeve EU/EN ose duke ditur formulën e përdorur nga ju për konvertimin nga ndriçimi aktual në atë të kërkuar, i jep mundësinë çdo OE të ofrojë produkte me efikasitet më të lartë sesa ato të kërkuara nga ju. Në lidhje me sa keni kërkuar, KSHA sqaron se vendosja e produkteve realizohet në bazë dhe për përmbushjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor dhe është ai që studion dhe përcakton dhe vendos se ku apo si do përdoren produktet.

Operatori Ekonomik është i detyruar thjeshtë të sigurojë produktet e kërkuara duke përmbushur të dhënat teknike të specifikuara dhe ofruar shërbimin e vendosjes së tyre, duke ju referuar ndryshimeve që do të pësoje dokumenti ngarkuar në SPE me emërtim “Lista e

materialeve”, si dokument që ka të detajuar specifikimet e mallrave të kërkuara. Pra kemi të bëjmë me procedurë furnizim vendosje.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

III.3.5. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se :

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.3.6. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, KPP gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet kërkesave dhe kriterëve të hartuara në dokumentat e tenderit, si edhe specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publike (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik. K.P.P sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit/punës dhe angazhimet e ofruara do të jenë të njëjtë me cilësinë dhe angazhimet e premtuar në ofertë. KPP gjykon se nga interpretimi teleologjik i dispozitave të sipërcituara arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur dhe gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë si dhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Sa më sipër, K.P.P gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të mbajë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 56 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë / përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe / ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe përcaktuese drejt një prodhuesi të caktuar, por duhet të lejojnë kapacitet mbi një minimum të caktuar pra të jepen të dhëna në vlera minimale dhe maksimale duke iu shmangur parametrave përcaktues të detajuar të cilët kufizojnë pjesëmarrjen e shoqërive, por duke e lënë opsionale plotësimin e kërkesës së mësipërme, duke e zgjeruar në këtë mënyrë konkurrencën dhe duke lejuar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

III.3.9. Në rastin konkret ankimuesi kërkon që për produktin ndriçues për secilin tip të përshkruar nga ana e autoritetit kontraktor tek lista e materialeve fuqinë e tyre të shprehur në WATT autoriteti kontraktor nuk duhet ta përcaktojë në mënyrë ekzakte fuqinë e ndriçuesit në WATT, pasi sot kompanitë prodhuese të ndriçuesve led kanë avancuar me teknologjinë e prodhimit duke prodhuar ndriçues me fuqi të ulët në WATT por me fuqi të lartë ndriçimi lumen, duke rritur në këtë mënyrë eficientë ndaj energjisë elektrike, ndaj dhe autoriteti kontraktor gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike të këtyre produkteve nuk duhet të shprehet apo të përcaktojë një parametër fiks siç është ai i fuqisë së ndriçuesit në WATT, por të përcaktojë vetëm fuqinë maksimale të tij, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë operatorëve ekonomikë që të ofertojnë produkte me një fuqi ndriçuesi në WATT më të ulët por duke rritur edhe eficientë e kursimit të energjisë dhe pa cënuar elementët e tjerë siç është fuqia e ndriçimit e shprehur në lumen, në këtë mënyrë ofertuesit nuk mund të kufizohen në ofertimin e këtij produkti, mund të ofertojnë dhe një ndriçues me parametra me të lartë se ajo të përcaktuar nga ana juaj, por jo me parametra më të ulët. Gjithashtu autoriteti kontraktor duhet të rishikojë edhe përmasat e ndriçuesve duke mos u shprehur me përmasa fikse por duke përdorur diapazon midis përmasave i cili nuk duhet të ndikojë në eficientë e produktit përfundimtar. Në këto kushte kur edhe në kthimin e përgjigjes autoritetit kontraktor lidhur me pretendimin e sipërpërmendur të ankimuesit nuk ka dhënë asnjë argument bindës që të kundërshtojë këtë pretendim. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike të gjithë tipet e ndriçuesve të më sipër cituar, në lidhje me përmasat e tyre, si dhe të përcaktojë vetëm vlerën maksimale të fuqisë të shprehur në WATT, duke i lënë mundësi operatorëve që të ofertojnë edhe produkte me të njëjtat karakteristika dhe parametra por me fuqi të ndriçuesit të shprehur në WATT më të ulët, e cila nuk do të cënonte thelbin e produktit, por do të rrisë eficientë në kursimin e energjisë elektrike. KPP gjykon se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Mag Utilities*” shpk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Mag Utilities*” sh.p.k. se “*Njësia juaj e prokurimit ka kërkuar në kundërshtim me Udhëzimet e APP edhe certifikatat ISO të prodhuesit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 9/2, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.5 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Kompanitë Prodhuese të produkteve të ofruara “Kalimi i ndriçimit në LED për eficientë energjitike në terminale dhe në infrastrukturën portuale”, kërkohen të jenë të certifikuar, sipas normave ISO 9001-2015 të standarëve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë dhe/ose të njëvlershme, të cilat do të garantojnë një sistem cilësor në procesin e prodhimit të produktit.

- a. Fusha e certifikimit duhet të përkojë saktësisht me kategorinë dhe specifikën e produkteve që prokurohen nga Autoriteti Kontraktor në objektin e këtij prokurimi me kategorinë dhe specifikat e shënuar në (1), më sipër.
- b. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme.
- c. Dëshmia për zoterimin e kësaj Certificate, duhet të jepet përmes origjinalit ose kopje e noterizuar. (e përkthyer dhe e noterizuar në shqip).

III.4.2. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: 1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore. 2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.3. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.4.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që 5 autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...] b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”

III.4.5. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti

kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.4.6. Në nenin 30 “Kërkesat e Cilësisë” pikat 1 dhe 2 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është përcaktuar: *1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

III.4.7. Në Rekomandimin Nr. 6732 Prot, datë 21.10.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, në pikën 6 citohet:

“[...]

Autoritetet kontraktore duhet të argumentojnë certifikatat ISO që kërkojnë nga operatorët ekonomikë në dokumentet e tenderit, në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit. Duke marrë shkas nga gjetjet e evidentuara në kuadër të verifikimit të procedurave të prokurimit, rekomandojmë që autoritetet kontraktore duhet të veprojnë konform nenit 46, pika 1, të LPP, sipas të cilit, operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Në çdo rast, autoritetet duhet të cilësojnë edhe variantet e tyre të përditësuara në kohën e zhvillimit të procedurës.

Autoritetet Kontraktore, në dokumentet e tenderit për mallra, apo edhe në rastin e punëve publike, kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin përveç autorizimit të prodhuesit, katalogëve, skedave teknike apo raporteve të testimi, edhe certifikata të ndryshme ISO që prodhuesi (i cili nuk ka lidhje me procesin) duhet të disponojë, veçanërisht certifikatë të menaxhimit të cilësisë së prodhuesit të mallit.

Në nenin 46, pika 2 të LPP parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit”.

Në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 parashikohet se: “AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Operatorët ekonomike ofertues në një procedurë, në varësi të objektit të prokurimit, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin/shërbimin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit rezulton t’i adresohet palevë të treta (prodhuesit/distributorit), të cilat nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit. Në këtë rast, rekomandojmë që AK

të vlerësojnë mundësinë e kërkesës/pranimit, të një vetedeklarimi nga OE ofertues që në këtë rast, prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe të rezervojë të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatave në fjalë.

Rekomandojmë që autoritetet kontraktore të shmangin kërkesa të tilla për dokumente që u drejtohen palëve të treta që nuk janë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, dhe për të garantuar cilësinë, të përcaktojnë te specifikimet teknike karakteristikat dhe kërkesat që mallrat duhet të plotësojnë.”

III.4.8. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.9. Sa më sipër, KPP nisur nga parashtrimet e operatorëve ekonomikë ankimues, në lidhje me pretendimet për heqjen e kërkesës për paraqitjen e certifikatës ISO 9001:2015 të prodhuesit, si dhe referuar “*Rekomandimit Nr. 6732 Prot, datë 21.10.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik*”, gjykon se, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit është kërkesë e cila i referohet kapacitetit teknik të prodhuesit të produkteve duke përfshirë ofertuesit furnizues (tregtar), nga procedura e prokurimit, në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së, si më sipër cituar. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kërkesa për pajisjen me ISO 9001:2015 të prodhuesit, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorite ekonomik ankimues “*Mag Utilities*” shpk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Mag Utilities*” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Në kundërshtim me Udhëzimet edhe Vendimet që APP ka dhënë, keni kërkuar certifikatën CE, e cila jepet vetëm pasi një shoqëri ka blerë mallin. Nëse nga ana juaj ndodheni në këto kushte, atëherë anuloni procedurën e prokurimit.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 9/2, pika 2.3.11 dhe 2.3.12 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

Për ndriçues Floodlight Tipi 1, Tipi 5, Tipi 6 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Certifikatat e Konformitetit (CE) sipas direktivave LVD/EMC si dhe Test Raportet përkatëse.

Për Streetlight Tipi 2, Tipi 3, Tipi 4 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Test Raportet sipas direktivave EMC/LVD si dhe Certifikatat e Konformitetit (CE).

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.5.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.

III.5.4. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.5.5. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pka 6/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:” c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.5.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.5.7. Markimi CE është një shenjë administrative që tregon pajtueshmëri me shëndetin, sigurinë dhe standardet e mbrojtjes së mjedisit për produktet e shitura brenda Zonës Ekonomike Evropiane. Ky markim nuk është një tregues i cilësisë ose një markë certifikimi. Markimi CE gjendet edhe në produktet e shitura jashtë Zonës Ekonomike Evropiane që janë prodhuar sipas standardeve të kësaj zone. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se paraqitja e Certifikatës së Konformitetit (për përputhshmërinë e produktit me standardet europiane, CE), është një kërkesë e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe duke qenë se, autoriteti kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të ofertojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata për të vërtetuar konformitetin e prodhimit të produkteve që do të përdoren në procedurën objekt prokurimi. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomik të provojnë se zotërojnë kapacitete teknike të duhura lidhur me konformitetin e artikujve objekt prokurimi. KPP gjykon se, përcaktimi i autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta për kualifikim se operatorët ekonomik për ndriçuesit Floodlight Tipi 1, Tipi 5, Tipi 6 dhe ndriçuesit Streetlight Tipi 2, Tipi 3, dhe Tipi 4 duhet të paraqesin certifikata CE, është diskriminues për vetë faktin se do të kufizonte pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, të cilët kryejnë furnizime të së njëjtës natyrë për produkte që janë prodhuar në vende të tjera dhe disponojnë markime ekuivalente me markimin CE. Sa më sipër, KPP gjykon se kriteri i mësipërm duhet të modifikohet në mënyrë që të lejojë që produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës mund të disponojnë certifikata/deklarata/markime ekuivalente me CE.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Mag Utilities*” shpk. qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Mag Utilities*” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 86748-02-11-2021, me objekt “*Zkalimi i ndriçimit në LED për efijencën energjitike në terminale dhe në infrastrukturën portuale*”, me fond limit 46,074,000 lekë pa TVSH, publikuar më datë 12.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “*Mag Utilities*” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 342 Protokoli, Datë 24.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri